



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 21451 Prot.

Lezhë, më 24.12.2021

VENDIM

Nr. 174 Datë 23.12. 2021

Për

Miratimin e kërkesës së Bashkisë Lezhë së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor për akordimin e ndihmes financiare për dëmin e shkaktuar nga djegia e banesës të shtetasit Vitor Palok Ndreka, banor në fshatin Zojs, Njësia Administrative Dajç, Bashkia Lezhë.

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ligjit Nr.45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", VKM Nr.329, dt.16.05.2012 "Për Kriteret dhe Procedurat e dhenies së ndihmes shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore" pasi u njoh me relacionin e pergatitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile, mbi dëmin e shkaktuar në banesën e Z.V.P.N., banor në fshatin Zojs, Njësia Administrative Dajç Bashkia Lezhë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

Vendosi:

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Lezhë për mbështetje financiare të shtetasit Z.V.P.N. për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.

A. Të miratojë dëmin e shkaktuar nga zjarri në vlerën 177301 lekë.
a) Dëmi i shkaktuar në ndertese 177301 lekë.
b) Dëmi i shkaktuar në orendi, mobilje e pajisje 0 lekë.

B. Mbështetur në VKM. Nr 329 dt.16.05.2012, kap3, pika 3, gërmat b e ç, kompensimi për dëmin e shkaktuar në anën ndërtimore të jete në masën 50%, ndërsa kompensimi për dëmin e shkaktuar në orendi, mobilje e pajisje, mbështetur në kap 3, pika 3, gërma d të VKM-së së mesiperme, të jete sa masa e dëmit të shkaktuar dhe konkretisht :

a) Vlera e kompensimit të dëmit në anën ndërtimore 88650 lekë.
b) Vlera e kompensimit të dëmit në orendi, mobilje e pajisje 0 lekë.

Vlera totale 88650 lekë.

2. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Lezhë.

3. Bashkia Lezhe t'i akordojë familjes së shtetasit Z.V.P.N.a me Nr.ID. G.....H ndihmen emergjente në vlerën prej 88650 (tetedhjetë e tete mije e gjashtë qind e pesëdhjetë) lekë nga buxheti i Bashkisë Lezhë, fondi i Emergjencave Civile i destinuar dhe i miratuar nga Keshilli i Bashkise per vitin 2021, bazuar ne VKM nr.329 dt.16.05.2012.

4. Ndhima financiare që do t'i akordohet do të përdoret për t'i ardhur në ndihme familjes së shtetasit Z V.P.N., banesa e të cilit është dëmtuar nga zjarri.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

6. Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ**



**KRYETARI
ERNEST RAKAJ**

